

VENDIM
Nr. 151, datë 10.3.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË ÇERDHESES "VALIAS", NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR, NË FSHATIN VALIAS, BASHKIA KAMZË, DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË KAMZË SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në vlerën 82 267 780 (tetëdhjetë e dy milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit të çerdhes "Valias", në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë.

2. Bashkisë Kamzë, në buxhetin e vitit 2021, i transferohet fondi në formën e transfertës së pakushtëzuar, në masën 16 453 556 (gjashtëmbëdhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e tre mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit të çerdhes "Valias", në zonën e re për zhvillim të detyruar, në fshatin Valias, Bashkia Kamzë.

3. Çaktimin e Bashkisë Kamzë si njësi zbatuese, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama